



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
BASHKIA PËRMET

BASHKIA PËRMET KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. ____ Prot.

Përmet, më ____/____/2023

RAPORT VJETOR PËR DËGJESAT PUBLIKE PËR VITIN 2022

Procesi i njoftimit dhe i konsultimit publik në Bashkinë Përmet gjatë vitit 2022 është bazuar në parimet e mëposhtme:

- a) *transparencë gjatë procesit të njoftimit e të konsultimit publik*
- b) *pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe jo-diskriminuese;*
- c) *efektshmëri e procesit të vendimmarrjes në organet publike;*
- d) *përgjegjësia e organeve publike ndaj palëve të interesuara.*

Procesi është realizuar në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 18, Ligjit Nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, dhe Ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Bashkia (Ekzekutivi) dhe Këshilli Bashkiak kanë bashkërenduar me qëllim realizimin e një procesi konsultimi efikas duke optimizuar burimet në dispozicion. Gjatë vitit 2022, janë realizuar 3 dëgjesa me banorë në qytetin e Përmetit dhe njësisive administrative përkatëse. Ndërkohë, për dëgjесat publike në kuadër të Buxhetit 2023, PBA 2023-2025 dhe Paketës Fiskale 2023, janë realizuar 4 konsultime të dokumentuara me proceverbal të plotë, pasqyruar¹ edhe në platformën konsultimivendor.al, në të cilën Bashkia Përmet ishte një ndër shtatë bashkitë pilot të përzgjedhura nga UNDP/STAR 3.

Gjate vitit 2022, Bashkia Përmet bashkëpunoi me Projektin STAR 3, përmes Qendrës për Çështje të Informimit Publik, INFOÇIP, për të rritur vizibilitetin e procesit të konsultimit publik si dhe për konsolidimin e një modeli që mund t’u shërbejë edhe bashkive të tjera të vendit. Të gjitha seancat konsultuese/dëgjесat janë pasqyruar në faqen zyrtare në internet të Bashkisë

¹Shiko procesverbalet e takimeve: <https://konsultimivendor.al/bashkia-permet-procesverbalet-e-takimeve-konsultative-per-konsultimet-publike-qe-jane-zhvilluar-ne-kuader-projekt-buxhetit-per-vitin-2023-pba-2023-2025-dhe-hartimit-te-paketes-fiskale-per/>

Përmet, në rrjetet sociale që ka në administrim Bashkia dhe Këshilli Bashkiak si dhe për herë të parë në Platformen: www.konsultimivendor.al në faqen e dedikuar Bashkisë Përmet brenda kësaj platforme (<https://konsultimivendor.al/bashkia-permet/>)

Ky Raport Vjetor është hartuar nga Bashkia Përmet në zbatim të detyrimeve që cakton për autoritetin publik neni 20 i Ligjit Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Sipas parashikimeve të këtij neni, organet publike hartojnë dhe të publikojnë raporte vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes, ku përfshihet informacion për:

- a) numrin e akteve të miratuara nga organi publik përkatës gjatë vitit referues;
- b) numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara;
- c) numrin e rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit;
- ç) numrin e takimeve publike të organizuara.

➤ **Numri i akteve të miratuara nga organi publik përkatës gjatë vitit 2022.**

Këshilli Bashkiak Përmet miratoi gjithsej 105 vendime gjatë vitit 2022² të cilat gjendet të publikuara në faqen zyrtare të Bashkisë Përmet si dhe në platformën e centralizuar VENDIME.AL, në të cilën ato gjithashtu publikohen konform standartit të unifikuar të publikimit.

➤ **Numri i përgjithshëm i rekomandimeve të marra nga palët e interesuara:**

Gjatë procesit konsultativ u regjistruan gjithsej 25 rekomandime konkrete.

➤ **Numri i rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të refuzuara:**

Nga 25 rekomandime, u mbajtën parasysht 18 dhe 7 u kthyen me motivim të arsyetuar nga zyrtarët publikë që u angazhuan në organizimin/drejtimin e dëgjësive.

➤ **Numri i takimeve publike të organizuara:**

1. Datë 17.01.2022 / Bashkia Përmet zhvilloi takim konsultativ me OSHC në kuadër të programit ReLoad 2.

Bashkia Përmet nëpërmjet faqes së saj zyrtare të internetit në datën 10.01.2022 publikoi njoftimin zyrtar për zhvillimin e takimit konsultativ me OSHC në kuadër të programit ReLoad 2. Bashkëlidhur njoftimit zyrtar, në platformën konsultimivendor.al në faqen e posaçme dedikuar bashkisë Përmet, u publikuan projekt-vendimi dhe relacioni për këtë konsultim. Takimi u

² Vendimet e vitit 2022 në Bashkinë Përmet mund të shihen në linkun: <https://www.vendime.al/category/permet/2022-permet/>

zhvillua në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak Përmet. Ky takim u drejtua nga Kryetarja e Bashkisë Përmet znj. Alma Hoxha dhe pjesëmarrës ishin përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile. Qëllimi i takimit ishte përcaktimi i prioriteteve për thirrjen e parë të projektit ReLoad 2 dhe përzgjedhja e përfaqësuesit nga shoqëria civile si anëtar i komisionit së vlerësimit të projekteve.

2. Bashkia Përmet njoftoi hapjen e konsultimeve me publikun për PBA 2023-2025, Buxheti 2023 dhe Paketën Fiskale 2023. (Asistuar nga INFOCIP / STAR 3)

Në datën 18.07.2022 Bashkia Përmet publikoi njoftimin për hapjen e konsultimeve me publikun për PBA 2023-2025, Buxhetin 2023 dhe Paketën Fiskale 2023. Ky njoftim u pasqyrua edhe në platformën konsultimivendor.al në faqen e posacme dedikuar kësaj bashkie (<https://konsultimivendor.al/bashkia-permet-hap-konsultimet-me-publikun-per-hartimin-e-buxhetit-per-vitin-2023/>), së bashku me projekt-vendimin dhe relacionin përkatës. Bashkia Përmet zhvilloi në total 4 konsultime në kuadër të buxhetit 2023 dhe PBA 2023. Të gjitha procesverbalet e takimeve gjenden në këtë link: <https://konsultimivendor.al/bashkia-permet-procesverbalet-e-takimeve-konsultative-per-konsultimet-publike-ge-jane-zhvilluar-ne-kuader-projekt-buxhetit-per-vitin-2023-pba-2023-2025-dhe-hartimit-te-paketes-fiskale-per/>. *Procesi i konsultimeve u finalizua me miratimin e VKB Nr.99. datë 05.12.2022 "Për buxhetin e bashkisë viti 2023 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të bashkisë, institucioneve dhe njësisve administrative në varësi të saj".³*

Takimet konsultative për PBA 2023-2025, Buxhetin 2023 dhe Paketën Fiskale në Bashkinë Përmet vijnë si mëposhtë:

2.1) Datë 04.11.2022 / Njësia Administrative Petran – Bashkia Përmet zhvilloi dëgjese publike në njësinë administrative Petran në kuadër të PBA 2023-2025 dhe Buxhetit 2023. Ky takim u drejtua nga Kryetarja e Bashkisë Përmet znj. Alma Hoxha. Pjesëmarrës ishin rreth 20 persona, ndër ta ishin kryetarët e fshatrave dhe përfaqësues të komunitetit. Fokus i diskutimit ishin problematikat që banorët kishin për t'u reflektuar më pas nga ana e bashkisë në buxhet për vitin 2023. Kryetarja e Bashkisë prezantoi punët e kryera dhe projektet prioritare për këtë njësi administrative. Procesi u dokumentua me procesverbal i cili gjendet në këtë link: <https://konsultimivendor.al/wp-content/uploads/2022/11/Procesverbal-Petran-1.pdf>

2.2) Datë 09.11.2022 / Njësia Administrative Piskove - Bashkia Përmet zhvilloi konsultimin publik në kuadër të "Projekt-Buxhetit 2023" dhe PBA 2023-2025" në njësinë administrative Piskovë. Ky takim u drejtua nën kujdesin e vecante të Kryetares së Bashkisë znj. Alma Hoxha. Pjesëmarrës ishin rreth 30 persona kryesisht, kryetarët e fshatrave dhe

³ Shih VKB: <https://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-permet-nr-99-date-05-12-2022/>

përfaqësues të komunitetit dhe bizneseve. Gjatë zhvillimit të takimit u adresuan dhe u identifikuan problematikat që banorët dhe përfaqësuesit e bizneseve hasnin në veprimtarinë e tyre të përditshme. Për të qënë transparent në çdo pjesë të territorit administrativ, pushteti lokal dëgjoi zërin e çdo banori për ti reflektuar në programet buxhetore dhe përkthyer në shërbime për vitin 2023. Takimi u dokumentua me procesverbal i cili gjendet në këtë link: <https://konsultimivendor.al/ep-content/uploads/2022/11/Procesverbal-Piskove.pdf>

2.3) Datë 19.11.2022 / Njësia Administrative Çarshove. Takimi në njësinë administrative Çarshovë në kuader të "Projekt-Buxhetit 2023" dhe PBA 2023-2025" u zhvillua në datën 19.11.2022. Dëgjesa u drejtua nga Kryetarja e Bashkisë Përmet znj. Alma Hoxha. Pjesëmarrës ishin rreth 25 persona, kryesisht kryetaret e fshatrave dhe përfaqësues të komunitetit dhe bizneseve. I gjithë procesi i këtij takimi u dokumentua me procesverbal i cili gjendet në këtë link: <https://konsultimivendor.al/wp-content/uploads/2022/11/Procesverbal-Carshove.pdf>

Datë 21.11.2022 / Bashkia Përmet zhvilloi konsultim publik me Këshillin Vendor Rinor.

Bashkia Përmet zhvilloi konsultim publik me të rinjtë dhe Këshillin Vendor Rinor. Takimi u zhvillua në kuadër të në kuadër të parashikimeve ligjore që permban ligji 75/2019 "Për Rininë". Konsultimi u ndermor në të njëjtën kohë me konsultimet për Buxhetin e Bashkisë dhe Te ardhurat për vitin 2023, në përputhje me të harmonizuar angazhimin për avancimin e axhendes rinore, si një detyrim ligjor i bashkisë që lidhet me funksionet e saj.

Takimi u zhvillua në sallën e Këshillit Bashkiak nën kujdesin e vecantë të Kryetares së Bashkisë Znj. Alma Hoxha, e bashkëshoqëruar nga Përgjegjësjë e Projekteve të Huaja znj. Kristjana Ibrahimimi dhe nga Specialisti për Rininë Z. Edjon Maliqi. Pjesëmarrës në këtë takim ishin rreth 20 të rinj. Ky takim u mbështet dhe u lehtësua nga Qendra për Cështjet e Informimit Publik (INFOCIP) dhe nga Drejtori i saj ekzekutiv z. Gerti Shella, në kuadër të projektit "*Promoting Public Consultations and Participation at Local Level*", mbështetur nga STAR 3/UNDP. Ky konsultim u dokumentua me procesverbal, në foto dhe në audio-video.⁴ Në këtë takim të rinjtë u njohën në mënyrë të detajuar me të drejtat dhe garancitë që i ofron ligji nr.75/2019 "Për Rininë" dhe më pas paraqitën idetë, kërkesat dhe sugjerimet e tyre për t'u patur në vëmendjen e bashkisë për hartimin e buxhetit të vitit 2023. Disa nga kërkesat e të rinjve ishin: t'i ofroheshen ambiente dhe terene për të zhvilluar aktivitete sportive, organizimi i aktiviteteve kulturore me mbështetjen e bashkisë, përfshirja e tyre në proces vendimmarrës etj.

⁴ Shih dokumentimin e plotë me procesverbal: <https://konsultimivendor.al/wp-content/uploads/2022/11/Procesverbal-Permet.pdf> dhe në audio-video-foto: <https://konsultimivendor.al/bashkia-permet-konsultim-publik-per-buxhetin-2023-me-te-rinjte-dhe-keshillin-vendor-rinor/>

3. Datë 14.09.2022 / Bashkia Përmet zhvilloi konsultim publik me temë “Për menaxhimin e mbetjeve urbane”

Bashkia Përmet njoftoi nëpërmjet njoftimit zyrtar në datën 25.08.2022 për zhvillimin e konsultimit publik me temë “Për menaxhimin e mbetjeve urbane”, i cili u publikua dhe në platformën konsultimivendor.al, bashkëlidhur me projekt-vendimin dhe relacionin përkatës. Takimi u zhvillua në sallën e Këshillit Bashkiak në datën 14.09.2022, në orën 11:00. Pjesëmarrës ishin rreth 30 persona, përfshirë këtu edhe përfaqësues biznesi.

Ky konsultim me banorët të Bashkisë Përmet pati për qëllim, mbledhjen e sugjerimeve të komunitetit lidhur me menaxhimin e mbetjeve në Bashkinë Përmet, si:

- a) Sugjerimi i vendosjes së orarit të hedhjes së mbetjeve në PGM nga familjaret-bizneset.
- b) Ndarja e mbetjeve urbane në burim.
- c) Riciklimi
- d) Ngritja e kapaciteteve për sektorin e pastrim-gjelberimit me vizionin për një qytet sa më të pastër dhe konform standarteve që kërkohen nga legjislacioni në fuqi.

I gjithë procesi u finalizua me miratimin e VKB Nr.75, datë 31.10.2022 “Për miratimin e rregullores për menaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Përmet”⁵

Ky takim u mbështet dhe u lehtësua nga Qendra për Cështjet e Informimit Publik (INFOCIP) dhe nga Drejtori i saj ekzekutiv z.Gerti Shella, në kuadër të projektit “Promoting Public Consultations and Participation at Local Level”, mbështetur nga STAR 3/UNDP.⁶

Konceptoi / Hartoi:

Koordinator për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, Bashkia Përmet
Albion Naska



⁵ Shiko VKB Nr.75, datë 31.10.2022 “Për miratimin e rregullores për menaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Përmet” : <https://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-permet-nr-75-date-31-10-2022/>